



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 660/1 Prot.

Tiranë, më 25.07 /2019

**VENDIM**

Nr. 20 datë 25.07. 2019

**“PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË NË  
SEKTORIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK  
TË TIRANËS”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e programit për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**ARBEN DHËMA**

